Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gjemajli Bellanica	**25.08.2023**	**08.09.2023**	**2023/0602**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.08.2023, OE "ALBKOS SAFETY SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0602, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me mjete dhe pajisje zjarrfikese." me nr. të prokurimit: "VU644-23-7665-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E VUSHTRRISË.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 25 000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Njoftimi per Kontrate 24.07.2023.

Sqarimi i dosjes se tenderit 04.08.2023.

Kerkesa per rishqyrtim 10.08.2023.

Vendimi i AK-se lidhur me kerkesen per rishqyrtim 11.08.2023.

Formulari per korrigjimin e gabimeve 11.08.2023.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

- Aneksi 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme
- Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 28 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 53 – Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit
- Neni 96 – I Rregullore për prokurimin publik 01.11.2022

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Më 04.08.2023 kemi bërë kërkesë për informata shtesë dhe me këtë rast AK e kemi njoftua paqartësive në specifikimet teknike, AK kishte vepruar edhe në kundërshtim me nenin 28, r specifikimet teknike i kishte përshtatur për OE / prodhues te caktuar.

Provë 01: Kërkesë për informata shtesë, më 04.08.2023
Dokumenti: 04_Kërkesë_për_informata_shtesë_KK_Vushtrri_04.08.2023.pdf

Meqenëse nuk kemi marrë përgjigje brenda afateve kohore te përcaktuara me dosje te ten kemi bere kërkesë për rishqyrtim.

Provë 02: Kërkesë për rishqyrtim, më 10.08.2023
Dokumenti: 06_Kerkese_per_rishqyrtim_10.08.2023.pdf

Më 11.08.2023, kemi pranuar vendimin e AK, i cili e ka aprovuar kërkesën si pjesërisht te ba si me poshtë:

> Pasi u shqyrtuan pretendimet e Op. Ek. të dhëna në Kërkesën për Rishqyrtim, duke marrë rekomandimin e Njësisë kërkuese të Autoritetit Kontraktues, lidhur me korrigjimin e Teknike, A.K. konstaton se Kërkesa për Rishqyrtim e Op. Ek. është pjesërisht e bazuar, Autoriteti Kontraktues, Specifikat Teknike për pajisjet dhe mjetet në fjalë do ti korrigjoi dhe harmoni me natyrën e aktivitetit të prokurimit, respektivisht me qëllimin e aktivitetit të prok që të jenë gjithëpërfshirëse, jo kufizuese dhe që i japinë hapësirë dhe mundësi O.E. të

Provë 03: Vendimi i AK mbi kërkesën për rishqyrtim, më 11.08.2023

Dokumenti: 07_Vendimi_i_AK_11.08.2023..pdf

Ne nuk pajtohemi me vlerësimin e AK se kërkesa për rishqyrtim është **"pjesërisht e bazuar"** me arsyetimin se **"specifikat teknike për pajisjet dhe mjetet ne fjalë do t'i korrigjoi..."**, sepse kërkesa për rishqyrtim nuk ka të bëjë me veprime të cilat AK planifikon t'i ndërmarrë në të ardhmen, por me veprime konkrete të ndërmarra nga AK deri në datën e kërkesës për rishqyrtim. Prandaj kërkesa për rishqyrtim është plotësisht e bazuar.

Më 11.08.2023, AK ka publikuar njoftimin për korrigjimin e gabimeve dhe versionin e korrigjuar të dosjes së tenderit. Megjithatë, AK nuk ka dhënë as sqarimet e as ndryshimet e nevojshme, në mënyrë që specifikimet teknike të jenë në përputhje me nenin 28 të LPP dhe nenin 1 të LPP.

Për më tepër, AK ka krijuar edhe më tepër konfuzion duke dhënë dy lloje specifikash dhe krijuar paqartësi se cilave specifika duhet t'i referohemi.

Provë 03: Versioni i korrigjuar i dosjes se tenderit i datës 11.08.2023 (shih faqet 18 – 26)
Dokumenti: 09_Verisioni_i_korrigjuar_i_DT_11.08.2023.Doc

Specifikimet teknike janë edhe me tutje ne kundërshtim me nenin 28 të LPP, sepse janë përshtatur për prodhues të caktuar, duke përjashtuar të gjitha mundësitë për një konkurrencë të barabartë dhe duke paracaktuar fituesin e tenderit.

Bëhet fjalë kryesisht për produkte të prodhuesve Stihl, VICTORINOX, Nightstic, Tipsa, etj., përfaqësi të një operatori të caktuar ekonomik për të cilin janë përshtatur specifikimet.

Për t'u siguruar që askush tjetër të mos mund të konkurrojë në këtë aktivitet të prokurimit, AK është kujdesur që të vë limite tilla në mënyrë që produktet tjera të mos i plotësojnë këtë kritere.

Për ilustrim po i përmendim një produkt dhe ne mënyrë të ngjashme janë vënë kufizime edhe ne produktet tjera. Produkti ne fjalë mund te gjindet ne linun: https://www.nightstick.com/collections/fire/products/xpp-5566rx.

Me poshtë krahasimet:

Specifikimi sipas AK	Specifikimi i prodhuesit
BATERI PROFESIONALE SHUME FUNSKIONALE – RIMBUSHËSE PËR ZJARRFIKES	
Bateria duhet te kete Lumen e lartë: 195-203	High Lumens: 200
Lumens mesatarë: 100 – 110	Medium Lumens: 110
Lumens e ulët: 55- 63	Low Lumens: 60
Lumens e dritës së dritës: 99 – 110	Floodlight Lumens: 100
Lumens me satarë të përmbytjes: 38 – 43	Flood Medium Lumens: 40
Lumenët e ulët të përmbytjes: max 20	Flood Low Lumens: 20
Lumenët e lartë DL: 200-209	High DL Lumens: 205
Distanca e rrezeve të larta (m): 399 – 402	High Beam Distance (m): 401
Distanca e rrezeve të mesme (m): 248-251	Medium Beam Distance (m): 250
Distanca e rrezeve të ulëta (m): 186-188	Low Beam Distance (m): 187
Mbrojtja IP-67 I pa përshkueshëm nga pluhuri/ I	High Candela: 40,256
papërshkueshëm nga uji	Medium Candela: 15,625
Kohë zgjatja e lartë (h): 6.5-7.3	Low Candela: 8,750
Kohë zgjatja mesatare (h): min 14	Drop Rating: 2 m
Kohë zgjatja e ulët (h): 26-27	Water Rating: IP-67 Dustproof/Waterproof
-20ºC ≤ Tamb ≤ +40ºC	High Runtime (h): 7
1.5V/Celi Alkaline	Medium Runtime (h): 15
3.7V/Cel Li-ion	Low Runtime (h): 27
Kohë zgjatja me përmbytje të lartë (h): min 6.5	High Flood Runtime (h): 7
Kohë zgjatja e përmbytjes mesatare (h): 14.5-15.30	Medium Flood Runtime (h): 15
Kohë zgjatja e ulët përmbytjeje (h): 26-27	Low Flood Runtime (h): 27
Kohë zgjatja me dy dritë të lartë (h): 7	High Dual-Light Runtime (h): 7
Koha e karikimit (h): 6	Strobe: Yes
ISO 9001:2015	Charge Time (h): 6
NFPA	Floodlight Color: White
Materiali:Polymer	Switch Function: Dual Body Switches –

Ngjyra: E verdhë/E zezë Gjatësia: 6,5 – 6,8 inç Gjerësia: 2,5 – 2,7 inç Thellësia: 2,6- 2,8 inç Pesha: max10,8 oz Diametri i kokës: min 52 mm	Light Source: LED Serialized: Y Case Material: Glass-filled Nylon Polymer Body Color: IS Green/Black Quantity of Batteries: 1 Power Source: Li-ion Rechargeable Package Contents: Light, Rechargeable Li-ion Battery, Charger, AA Battery Carrier, AC/DC Cords US Patent(s) : 9713217 and 10119663 Warranty: Limited Lifetime Warranty DIMENSIONS Length: 6.6 in (168 mm) Width: 2.6 in (66 mm) Depth: 2.6 in (66 mm) Weight: 10.6 oz (301 g) Head Diameter: 2.1 in (53 mm)

Një produkt tjetër është, artikullin nen nr. 8, të cilin e AK e kishte përshkruar edhe ne një tender të mëhershëm, për të cilin OSH kishte marrë vendim (vendimi nr. 200-22Ankesa.pdf i datës 13.06.2023) dhe kishte konstatuar se është ne kundërshtim me nenin 28 të LPP:

8. POMPE SHPINORE, KAPACITET 19 deri 20Lit.

Rezervoari:
Rezistenca e tërheqjes dhe deformimit sipas EN 1421/V1
Fortësia e grisjes sipas DIN 53363
Testi i plasaritjes sipas DIN 53359 A
Testuar per perdorim ne temperature: -40°C/+70°C sipas EN 1876-1
Rezistent ndaj zjarrit si pas DIN 4102
Rezervuari rezistent ndaj flakes dhe temperatures, tip-2
Salduar me termo-saldim
Canta per ruajtje (deponim) tepompesdhe transport me telehte
Rrypa te mbushur per krahror
Rryp brezi per stabilitet gjate bartjes
Pesha: max. 2kg
Ngjyra: e verdheose e kuqe

Pompe edores:
Piston me dy drejtime, punuar prej bronzi të kromuar me filter inox.
Gryka e pompes qe rregullohet me:
-rrjedhje te drejtë (jet) > 12 m
- rrjedhje me spërkatje (mjegull)> 3 m

Edhe përshkrimi per produktet tjera eshte bere ne kundërshtim me LPP, andaj kërkojmë nga OSHP që të ndërmarr masa ndaj AK për të krijuar kushte të barabarta pjesëmarrjeje në këtë aktivitet prokurimi dhe qartësi në specifikimet teknike,

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1. Operator Ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të Themelimit. Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të jetë i regjistruar si deklarues i TVSH-së.	**Dëshmia 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit e kompletuar, duhet të dorëzohet kopje.**
Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të jetë i regjistruar si deklarues i TVSH-së.	**Dëshmia 2. Çertifikata e TVSH-së valide të dorëzohet në kopje.**
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
n a	**n a**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te furnizimeve te njgjashme, në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, jo më pak se 30,000.00 euro. Në rast të Grupit të Op.Ek. lideri i grupit duhet të ketë projekte të punës të realizuara gjatë tre viteve të fundit deri më datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë jo më pak se 60% të vlerës së saktësuar si më lartë.	**Dëshmia 1. Listën e nënshkruar dhe të vulosur me të cilën specifikohen të gjitha projektet e furnizimeve të ngjashme të operatorit ekonomik të realizuara përfunduara në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose raportet e pranimit për kryerje të furnizimeve, vlera e të cilave duhet të arrijë së paku vleren e specifikuar në kërkesën nr.1** **(i) Kur furnizimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e raporteve të pranimit ose referencë ,të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë;** **(ii) Kur furnizimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi të mallit shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i furnizimeve të tilla;**
Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalogun ose fotografi se bashku me specifikimet teknike për të gjithë artikujt të saktsuar në dosjen e tenderit Aneksi nr.1	**Dëshmia 2. Katalogu me fotografi së bashku me specifikimet teknike me fotografi të nënshkruara dhe vulosura për të gjithë artikujt e saktsuar Aneksin nr.1**
Kërkesa 3. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se mallrat e ofruara i përmbushin specifikat teknike të kërkuar si në aneksin nr 1. të dosjes së tenderit.	**Dëshmia 3. Deklaratën me shkrim, e nënshkruar dhe e vulosur, me të cilën OE garanton për përmbushjen e specifikave teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ALBKOS SAFETY SH.P.K.**

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

Përmbledhje e pretendimit ankimor

OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 28 të LPP-së gjatë hartimit të specifikave teknike, për shkak se specifikat teknike i ka përshtatur për OE/ prodhues të caktuar.

OE ankues thekson se me dt. 04.08.2023 kemi bere kerkese per informata shtesë dhe brenda afatit kohor nuk kemi marrë përgjigjje dhe kemi bërë kërkesë për rishqyrtim me dt. 10.08.2023, ku kërkesa jonë për rishqyrtim është aprovuar si pjesërisht e bazuar me arsyetimin se AK, specifikimet teknike për pajisje dhe mjetet në fjalë do ti korrigjoj dhe përshtat në

harmoni me natyrën e AP. Ne nuk pajtohemi me vlerësimin e AK-së me arsyetimin e AK-së, sepse kërkesa për rishqyrtim nuk ka të bëjë me veprimet të cilat AK planifikon t'i ndërmarrë në të ardhmen.

Me dt. 11.08.2023 AK ka publikuar njoftimin për korrigjimin e gabimeve dhe versionin e korrigjuar të DT-së. Megjithatë AK nuk ka dhënë sqarime as ndryshimet e nevojshme në mënyrë që specifikimet teknike të jenë në përputhje me nenin 28 të dhe Nenin 1 të LPP-së.

Specifikimet teknike edhe më tutje janë në kundërshtim me nenin 28 të LPP – së, sepse janë përshtatur për prodhues të caktuar, duke përjashtuar të gjitha mundësitë për një konkurrencë të barabartë dhe duke përcaktuar fituesin e tenderit, si dhe bëhet fjalë për produkte të prodhuesve Sthil, Victor Inox, Nightstic, Tipsa etj, përfaqësi të një operatori të caktuar ekonomik.

Përgjigjje në pretendimin ankimor

Pas analizimit të dokumentacionit të lëndës të ofruar në E prokurim, eksperti shqyrtues sqaron se me dt. 04.08.2023 OE ankues ka paraqitur kërkesë për informatë shtesë në lidhje me arsyetimin se specifikimet teknike janë në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së dhe favorizojn prodhues të caktuar dhe OE. Ndërsa me dt. 10.08.2023 OE ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim, ku me dt. 11.08.2023 i është aprovuar kërkesa për rishqyrtim si pjesërisht e bazuar dhe në të njejten ditë është bërë edhe publikimi i dosjes së tenderit i ndryshuar, ku edhe më tutje OE ankues pretendon se specifikat teknike edhe më tutje janë në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së.

OE ankues me theks të veçantë në ankesë ka paraqitur pretendime ankimore për pozicionin 6 dhe 8 të specifikacionit teknik, duke mos anashkaluar edhe pozicionet tjera në kuptim të përgjithshëm.

Në pozicionin nr.6 "Bateri profesionale shumë funksionale- rimbushëse për zjarrfikes", e kerkuar nga ana e AK-së, eksperti shqyrtues ka hulumtuar në internet dhe ka vërejtur se

specifikat teknike të kërkuara nga AK për këtë pozicion, ngjasojnë me specifikat e produktit (baterise) "XPP-54566RX" të prodhuesit "NIGHTSTICK". Andaj eksperti shqyrtues vlerëson të qëndrueshëm pretendimin ankimor dhe se AK duhet t'i heq limitet të cilat favorizojnë ndonjë OE apo ndonjë prodhues të caktuar dhe të hap konkurencën në mënyrë që të ketë më shumë OE pjesmarrës dhe të veproj në plotni me paragrafet e nenit 28 të LPP-së.

Në lidhje me pozicionin nr.8 të paramasës, ku OE ankues thekson se ky artikull është përshkruar edhe në një tender tjetër nga ana e AK-së për të cilin OSHP kishte konstatuar që është në kundërshtim me Nenin 28 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues, vlerësone se duke u bazuar ne ankesin 1, specifikime teknike të detyrueshme dhe ne pretendimin ankimore të OE ankues për Pozicioni nr.8 "Pompe shpinore, kapacitet 19 deri 20 Litër", pas verifikimeve te bere ne internet, konkretisht në webfaqen e prodhuesit "https://www.tipsa.com/product-category/genfo-backpacks/.", rezulton se specifikat teknike të kërkuara nga AK-ja për pozicionin nr.8 ngjasojnë me specifikat teknike të nje prodhuesi të caktuar "Genfo " e qe është në kundërshtim me neni 28 dhe neni 7 si dhe me të gjitha dispozitat ligjore te LPP-se.

Andaj, eksperti shqyrtues rekomandon që të aprovohet ankesa e OE, dhe AK-ja të mos vej limite të cilat favorizojnë ndnjë prodhues apo ndonjë OE, si dhe kërkesat për specifika teknike të mos i referohen ndonjë prodhuesi të caktuar, apo brendi të caktuar. Të veprohet në plotni me nenin 28 të LPP-së, dhe të zgjatet afati për ofertim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E VUSHTRRISË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ALBKOS SAFETY SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Gjemajli Bellanica

Gj. Bellanica